



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.966/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Germova” Sh.P.K me seli në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, Sh.P.K, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulimin e vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.158/20 të datës 02.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “Germova” Sh.P.K me seli në Mitrovicë, e datës 27.10.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1320/18, i datës 13.11.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Germova shpk me seli në Mitrovicë, si e pa bazuar. Ndërkaq me pikën II. Të dispozitivit është lënë në fuqi Vendimi nr.506/2019 i datës 12.12.2019 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Administrata Tatimore e Kosovës në rivendosje është refuzuar si e pa bazuar ankesë e paditësit, dhe e paditura e ka lënë në fuqi vendimin nr.550/2016 të datës 21.12.2016 lëshuar nga Divizioni i Ankesave i ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës e ka rishqyrtuar ankesën e paditësit, pasi fillimisht në lidhje me këtë çështje ka vendosur edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, sipas Aktgjykimit A.nr.98/17, dt.09.10.2019, sipas të cilit Aktgjykim është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar vendimi i kontestuar dhe lënda përsëri është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës.

Me rastin e rishqyrtimit të ankesës së paditësit, e paditura ATK në procedurën e brendshme administrative e ka ndëshkuar paditësin me gjobë në vlerë prej 5,000.00 €, me arsyetimin se paditësi ka keqpërdorur certifikatën e TVSH-së të një subjekti tjetër. Në këtë konkluzion e paditura ka arritur pasi që sipas saj paditësi nuk ka pasur autorizim të rregullt, për të kryer procedurën e zhdoganimit pranë Doganës së Kosovës, në emër të subjektit PP Fero Steel 028, është krejtësisht e pa logjikshme se si ATK-ja e ka konsideruar se paditësi ka keqpërdorur certifikatën e TVSH-së të këtij subjekti të lartpërmendur, me arsyetimin se nuk ka pasur autorizim i cili i përmbushë të gjitha detajet për të qenë një i tillë. Autorizimi për kryerjen e procedurave doganore shërben për tu paraqitur pranë Doganës së Kosovës, i cili edhe institucioni që vlerëson nëse autorizimi për kryerjen e procedurave doganore është i rregullt apo jo dhe nëse i përmbushë të gjitha elementet për të qenë i tillë.

I pakënaqur me vendimin administrativ të paditurës, paditësi ka parashtruar padi për anulimin e aktit administrativ, duke pretenduar se e paditura asnjëherë nuk e ka kontestuar këtë autorizim të cilën e paditura e ka konsideruar si jo të rregullt dhe paditësi sipas këtij autorizimi ka kryer procedurën e zhdoganimit për subjektin në fjalë. Të metat e vendimit të kontestuar janë vë në dukje edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së parë, e cila e ka obliguar të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje të vërtetojë saktë gjendjen faktike dhe me të cilat veprime kontratë paditësi e ka keqpërdorë certifikatën e TVSH-së, dhe cilat kanë qenë përfitimet e tij nga ky keqpërdorim. Gjithashtu gjykata e ka obliguar të paditurën që të cekë dispozitën ligjore se ku është bazuar që e ka konsideruar përmbajtjen e autorizimit të paraqitur Doganës si jo të rregullt. E paditura nuk ka mundur sipas vendimit të kontestuar që të japi përgjigje këtyre vërejtjeve të Gjykatës së Prishtinës, e paditura ka cekur edhe Ligjin e Notarisë, ku sipas saj autorizimi në fjalë nuk është bazuar në këtë Ligj, por e paditura nuk e ka cekur faktin se ky Ligj ka hyrë në fuqi më vonë e jo në kohën në të cilën behet fjalë në këtë çështje. Ka theksuar se autorizimi të cilin subjekti "Fero Steel, ia ka dhënë paditësit, ka qenë vetëm për kryerjen e procedurës së zhdoganimit dhe kjo në asnjë rast nuk mund të përbëjë keqpërdorim të certifikatës të TVSH-së, ashtu siç pretendon e paditura.

Gjykata e Shkallës së Parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë dhe në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të

cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Vendimi nr.506/2019 i datës 12.12.2019 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata në këtë procedurë të konfliktit administrativ nuk ka pranuar pretendimet e paditësit dhe ka konstatuar se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka konfirmuar si të bazuar vendimin nr.550/2016 të datës 21.12.2016, përmes të cilit paditësit i është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar Dokumenti i vendosjes së ndëshkimit MFA2R000004542U i datës 22.11.2016 në vlerë prej 5,000.00€, në bazë të nenit 58.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykata nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të ndryshonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja që ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se ndëshkimi për keqpërdorim të certifikatës së TVSH-së për periudhën 2010-2011, ka rezultuar nga të dhënat e grumbulluara dhe procesverbali datës 03.11.2016 i marrjes në pyetje nga hetuesit tatimor, deklaratimet e pronarit të paditësit H.I., i cili ka deklaruar se nuk e njeh pronarin e biznesit PP Fero Steel 028-Z.H., nuk ka kontaktuar më të asnjëherë dhe nuk ka qenë në dijeni që ky person ia ka dhënë autorizimin në emër të biznesit PP “Fero Steel 028”. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje e paditura ka dhënë sqarimet e nevojshme për gjykatën, lidhur me veprimet e paditësit dhe subjektit PP Fero Steel 028, në drejtim të keqpërdorimit të certifikatës së TVSH-së gjatë zhdoganimit të mallit doganor tek autoritetet e Doganës së Kosovës. E paditura në rivendosje në arsyetimin e vendimit kontestues ka bërë me dije se me datën 22.11.2016 është ndëshkuar edhe subjekti PP Fero Steel 028 në vlerë prej 5,000.00€ për periudhën 07/2011 në bazë të nenit 58.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe i njëjti subjekt nga viti 2012 nuk është aktiv, të cilit i është anuluar certifikata e TVSH-së nga ATK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtuan edhe pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës

materiale, mirëpo gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për të provuarit e fakteve vendimtare. Në këtë drejtim, Kolegji përkrah konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se ndëshkimi për keqpërdorim të certifikatës së TVSH-së për periudhën 2010-2011, ka rezultuar nga të dhënat e grumbulluara dhe procesverbali datës 03.11.2016 i marrjes në pyetje nga hetuesit tatimor, deklaratimet e pronarit të paditësit H.I., i cili ka deklaruar se nuk e njeh pronarin e biznesit PP Fero Steel 028-Z.H., nuk ka kontaktuar më të asnjëherë dhe nuk ka qenë në dijeni që ky person ia ka dhënë autorizimin në emër të biznesit PP “Fero Steel 028”.

Kolegji i kësaj gjykate përkitazi me pretendimet ankimore vlerëson se në rastin konkret Gjykata nuk ka mundur t’i marrë për bazë pretendimet e paditësit se i njëjti për shfrytëzimin e certifikatës së TVSH ka poseduar autorizimin e datës 03.05.2010. Gjykata konstaton se ky autorizim nuk mund të konsiderohet valid, për arsye se nuk është i nënshkruar nga pronari-dhënsi i autorizimit PP Fero Steel 028, fakt të cilin e pranon edhe pronari i paditësit gjatë deklaratimit pranë hetuesve tatimor (procesverbali i datës 03.11.2016), ndërsa autorizimin e noterizuar nr.6696/2016 dt.14.11.2016 të cilin e ka siguruar paditësi pas ndëshkimit, gjykata pranon konstatimet e të paditurës, se ky autorizim ka efekt veprimi prej datës kur është vërtetuar tek noteri datë 14.11.2016, prandaj gjykata nuk mund ta konsideroj këtë Autorizim valid për periudhën 2010, 2011, kur paditësi ka zhdoganuar mallrat doganor, duke përdorur certifikatën e subjektit tjetër pa autorizim valid.

Kolegji vlerëson se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë kur ka konstatuar se në arsyetimin e vendimit kontestues të organit administrativ janë dhënë arsye të mjaftueshme se në të kaluarën për të gjitha subjektet ekonomike që merren më këtë veprimtari janë pranuar gabimisht humbjet edhe pse subjektet nuk kanë dëshmuar me prova përqindjen e humbjeve. Në këtë drejtim kjo gjykatë pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se e paditura nuk ka mundur të arsyetoj se kjo e drejtë për pranimin e humbjeve të derivateve për mallin që gjendet në depo doganore kishte bazë ligjore.

Qëndrojnë konkludimet e gjykatës së shkallës së parë se e paditura ka dhënë sqarimet e nevojshme për gjykatën, lidhur me veprimet e paditësit dhe subjektit PP Fero Steel 028, në drejtim të keqpërdorimit të certifikatës së TVSH-së gjatë zhdoganimit të mallit doganor tek autoritetet e Doganës së Kosovës. Në këtë drejtim, e paditura në rivendosje në arsyetimin e vendimit kontestues ka bërë me dije se me datën 22.11.2016 është ndëshkuar edhe subjekti PP Fero Steel 028 në vlerë prej 5,000.00€ për periudhën 07/2011 në bazë të nenit 58.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe i njëjti subjekt nga viti 2012 nuk është aktiv, të cilit i është anuluar certifikata e TVSH-së nga ATK-së.

Lidhur me të drejtën materiale, Kolegji vlerëson se gjykata drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe në veçanti vendimi objekt shqyrtimi me të cilin është ndëshkuar paditësi, i referohet dispozitës së nenit 58 paragrafi 4 i Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, që parasheh se

“Një tatimpagues i regjistruar për TVSH i cili i lejon një personi tjetër të përdorë certifikatën e tij unike të TVSH-së, do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ prej pesë mijë (5.000) Euro. I njëjti ndëshkim aplikohet edhe ndaj personit i cili përdorë një certifikatë të TVSh-së që i përket dikujt tjetër.”

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i mori si të bazuara, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.966/22, me datë 10.05.2023

Kryetari kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova